

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 21 PRILL 2022

Zonja Kryetare, e përshëndes këtë rregullin e fortë që vutë në momentin e fundit! Për procedurë, ju kujtoj që nuk duhej të fliste Edi Rama, por në Rregulloren që ju keni përpara thuhet: “Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë”, pra nuk thotë të pritët që të flasë Edi Rama dhe kushdo. Së pari.

Së dyti, zonjë, po në nenin 47 thuhet: “Për paraqitjen e projektligjeve (gjë që e ke filluar me dy diskutimet radhazi), Kryeministri dhe ministri flasin pa asnjë kufizim”. Nuk kam asnjë vërejtje për këtë çështje, por ju e keni prerë fjalën, me të drejtë, për njerëz që nuk flasin lidhur me rendin e ditës. Degradimi i kësaj salle të parlamentit për shkak se Edi Rama ka nevojë që sallahanen që vjen erë të qelbur për çështjen e Presidentit do të na fusë këtu në sallë dhe ato landfillet do t’i fusë këtu në sallën e parlamentit, është halli i tij. Historia ka parë edhe të çmendur që e kanë bërë kalin senator dhe nuk ka ndonjë çudi të madhe të shohë se si do të grumbullohen një tufë me vota për ta çuar rripin e pantallonave të Edi Ramës në Presidencë, që ta zgjidhë dhe ta lidhë si të dojë, por këtë ju nuk keni asnjë të drejtë të na e sillni këtu.

Në rast se doni të bëni debat për Presidentin, për procedurat apo për këto sallahanet që duan të bëjnë këtu, hapni një pitë debati ku të gjithë të marrin dhe të diskutojnë, por nuk mund të jetë salla e parlamentit që, kur do Edi Rama, të flitet, kur do kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, të ndërpritët seanca. Kjo nuk është salla e mbledhjes së qeverisë, ku Edi Rama bën çfarë të dojë, luan basketboll, vë edhe kanotierën që i vjen erë e qelbur djerse atje, pra bën çfarë të dojë, kjo është salla e parlamenti të Shqipërisë. Ju e keni këtë detyrim, zonja Kryetare, pavarësisht se kush ju ka vënë në atë karrige. Ju kanë vënë këta, por keni këtë Rregullore për të zbatuar dhe kësaj nuk i del njeri përsipër, çfarëdo që të jetë, ministër apo çfarë të jetë, sepse kemi parë kryeministra dhe ministra që nuk janë më, dhe nuk po kërkojmë asgjë më shumë dhe asgjë më pak.

E keni qelbur këtë sallë të parlamentit, kemi dëgjuar një të çekuilibruar psikikisht që ka funeral mendimi në mendjen e tij, sepse po të mos kishte funeral mendimi, nuk do të kishim atë hata që kemi me çmimet dhe një krizë ekonomike. Sot kemi hapur një diskutim, ju e keni hapur debatin për një projektligj ku do të merren 80 milionë euro të tjera, ndërsa ne këtu dëgjojmë sallahanet e Edi Ramës. Po jua them edhe një herë tjetër: kjo situatë është shumë e rëndë, ku për të justifikuar, po jua them prapë, rripin e pantallonave të Edi Ramës, që do të shkojë në Presidencë, ndërprisni punimet korrekte dhe të rregullta të parlamentit.